



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



Save the Children

Një botë ndryshe

Buletin i përtremuajshëm
i organizatës "MEDPAK"

Për më shumë informacion kontaktoni në tel me nr 042345028 dhe 0693577247



MEDPAK

Adresa: Rruha "Sh. Ishmi", Pallati 38,
Shkalla 1, Apt. 2, Tiranë
Tel: +355 4 23 45 028
Mobile: +355 69 3577 247 / +355 68 2578 002
E-mail: info@medpak.org
website: www.medpak.org
FB: @MEDPAK.ALBANIA

Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7,
ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë, Albania
Tel: +355 4 2261840 / 2261929
E-mail: info.albania@savethechildren.org
<https://albania.savethechildren.net>
 Savethechildrenal
 SaveChildrenAlb

Ky Buletin del në periudhën kur MEDPAK është duke realizuar projektet: **“Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri”**, dhe projektin **“Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara”**.

Projekti **“Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri”** zbatohet në partneritet me organizatën Save the Children mbështetur nga Kooperacioni Italian për Zhvillim / Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë. Fokusi i projekti është arsimimi në shkolla gjithëpërfshirëse i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë. Projekti zbatohet në 14 shkolla dhe 14 kopshte, në shtatë rajone të Shqipërisë: Gjirokastrë; Korçë; Elbasan; Durrës; Burrel; Peshkopi dhe Vlorë. Qëllimi i projektit është promovimi i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara (AK) dhe vështirësi në të nxënë (VN). Ky projekt kërkon të nxis arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) dhe vështirësi në të nxënë (VN) në kopshtet dhe në shkollat 9-vjeçare, përmirësimin e kompetencave të të gjithë aktorëve si në nivel qendror edhe atë lokal, promovimin e figurës së mësuesit ndihmës në shkollë si dhe promovimin e një kulture gjithëpërfshirëse dhe luftimit të stereotipeve negative.

Projekti **“Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara”** po zbatohet në partneritet me shoqatën Partnerë për Fëmijët dhe World Vision. Ky projekt zbatohet në 9 rajone Korçë; Elbasan; Tiranë, Peshkopi , Vlorë, Kukës, Shkodër, Lezhë dhe Tropojë. Projekti synon të rrisë angazhimin dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve arsimore, duke hedhur bazat e një rrjeti (network) ndërmjet institucioneve që punojnë me fëmijët dhe për fëmijët. Ky projekt po ndihmon në krijimin e kushteve të përshtatshme, në mënyrë që çdo nxënës, përfshi edhe atë me aftësi të kufizuara, të zhvillojnë kapacitetet e tyre përkrahë bashkëmohatarëve, në kopshte e shkolla gjithëpërfshirëse. Aktivitetet kryesore të këtij projekti janë bashkëpunimi i OJF-ve që punojnë për fëmijët në rajon, sensibilizimi për të drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara i strukturave të shkollës (bordi i shkollës, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve dhe komuniteti shkollor në tërësi).

Duke konsideruar pozitivisht arritjet dhe rezultatet e projekteve një numër i konsiderueshëm punonjësish arsimor, prindër, përfaqësuesë të pushtetit vendor, bashkëmohatarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe anëtarë të komunitetit janë duke rritur dhe zgjeruar kapacitetet dhe aftësitë e tyre për të përqsuar praktika gjithëpërfshirëse, për të kontribuar aktivisht në zbatim të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar në shkollat e arsimit bazë.

Projektet kanë forcuar bashkëpunimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe aktorëve të tjerë përgjegjës duke i konsideruar ata partnerë të barabartë dhe me të drejta të plota në këtë proces.

Po unë ç'mund të bëj!!!

Sot në klasë, në orën e qytetarisë kishim një mysafire. Mësuesja kishte ftuar mamën e Borës, shoqes tonë të klasës. Mësuesja na prezantoi të ftuarën znj. Pranvera e cila gjatë prezantimit të saj na tregoi se punonte juriste në një shoqatë për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kush ishte qëllimi që ajo ishte sot këtu mes nesh? Mos ndoshta vallë do të na ftonte të vizitonim shoqatën ku ajo punonte? Apo do të kërkonte që në të zhvillonim një aktivitet me fëmijët pjesë e shoqatës? Mos ndoshta kërkon të mbledh ndonjë fond në ndihmë të këtyre personave? Pse ishte ajo sot këtu???



Mësuesja filloi të na ndante në bangë disa fisha në të cilat ishte shkruar një tekst. Në bazë të numrit që ishte vendosur në fillim të fishës do të fillonim të lexonim tekstin me zë të lartë.

“Era është kushërira ime dhe është moshatare me mua. Ajo banon në një fshat malor. Shpesh së bashku me prindërit shkojmë për ta vizituar familjen e saj. Sot jam në shtëpinë e Erës dhe po e dëgjoj me vëmendje teksa po më tregon për kuriozitetet më të fundit shkencore që ka lexuar. Buzëqeshja nuk i ndahet kurrë nga fytyra. Ajo nuk përton t’i përshëndesë të gjithë banorët, ndërsa ecën me karrocën e saj rrugëve të fshatit. Familja e saj ka vendosur

të transferohet në qytet, pasi Era ka nevojë për disa shërbime të specializuara, të cilat nuk ofrohen në fshatin ku ajo jeton. Prindërit e Erës duan të gjejë një apartament në katin e parë ose një shtëpi private në lagjen tonë, për ta marrë me qira. Era nuk mund të ngjitet e të zbrisë nëpër shkallë. Ata i shqetëson edhe shkollimi i Erës. Ajo nuk mund të regjistrohet në shkollën time, pasi në hyrje të saj ka disa shkallë, të cilat Era nuk i kalon dot. Jo vetëm kaq, por aty nuk ka as tualete të përshtatura për nevojat e saj specifike. Si do ta zgjidhe Era këtë problem. Situata e saj na shqetëson të gjithëve.”



Mësuesja shkroi në dërrasë të zezë pyetjen për të cilën ne duhet të diskutojmë: A krijojnë mjediset ku ne jetojmë çdo ditë, mundësi për Erën dhe bashkëmoshatarët e saj me aftësi të kufizuara? Po shkolla jonë është shkollë gjithëpërfshirëse, çfarë ofron ajo për nxënësit si Era?

Diskutuam me mësuesen opinionin tonë dhe gjatë diskutimeve vumë re se shumë gjëra mungonin.

Mamaja e Borës na tregoi se sa shumë ndryshime kishin ndodhur në vendin tonë ndër vite. Ajo u ndal në Shqipërinë e para viteve 90, ku personat me aftësi të kufizuara trajtoheshin kryesisht si të sëmurë, që do të thotë se ata kishin nevojë vetëm për trajtim dhe kujdes shëndetësor. Ky ishte modeli mjekësor – thotë ajo - duke lënë jashtë vëmendjes çdo nevojë tjetër të tyre për arsimim, për argëtim etj. Kjo vërtetohet më së miri vazhdoi rrëfimin e saj edhe me faktin se të gjitha institucionet e kujdesit për individët me aftësi të kufizuara në ato vite ishin nën varësinë Ministrisë së Shëndetësisë dhe ishte e vështirë të mendohej arsimimi, punësimi dhe përfshirja e tyre në radhët e shoqërisë. Zhvillimet e vrullshme që shoqëruan shoqërinë shqiptare

në fillimin e viteve 1990 pas rënies së komunizimit, sollën ndryshimet e para në mënyrën e trajtimit të individëve me aftësi të kufizuara, duke filluar që nga kuadri ligjor e më gjerë. Shqipëria nisi gradualisht të integrojë disa elementë socialë në trajtimin e aftësisë së kufizuar, krahas atyre mjekësorë. Kjo u bë e dukshme në dokumentat kryesorë ligjorë të asaj kohe. Ato kulmuan me ratifikimin në vitin 2012, të Konventën e të Drejtve të Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPK). Sot fëmijët me aftësi të kufizuar me të drejtën që u jep ligji janë pjesë e shkollave publike. Sot ne flasim për gjithëpërfshirje, por si shoqëri kemi shumë punë për të bërë duke filluar që nga çerdhet, kopshtet shkollat dhe në mjedise të tjera publike etj.



Po ju si fëmijë, si mund t'i ndihmoni bashkëmohatarët tuaj me aftësi të kufizuar?
– kjo ishte pyetja që mamja e Borës mbylli diskutimin.

Kishim shumë pyetje atë ditë dhe ora na u duk shumë e shkurtër. Zilja sapo ra për të lajmëruar se ora mbaroi, por ne vazhdonim të diskutonim me njëri tjetrin se çfarë mund të bënim ne për bashkëmohatarët tanë me aftësi të kufizuar?!



Shkroi : E.Ajazi
Klasa e 6, Durrës

Të përshpejtohen hapat që duhen hedhur në nxitje të zbatimit të ligjit për arsim gjithpërfshirës për fëmijët më aftësi të kufizuara

Koalicioni Shqiptar “Aftësia e kufizuar dhe Zhvillimi” (ADDC), gjatë periudhës 2009- 2012 ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e diskutimeve për hartimin e ligjit të arsimit parauniversitar duke luajtur një rol të rëndësishëm gjatë fazës së përgatitjes dhe miratimit të këtij ligji gjithpërfshirës. Ligji për Arsimin Parauniversitar është vlerësuar si një kuadër ligjor tejet bashkëkohor e në përputhje me linjat e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Koncepti i të drejtës për të arsimuar të gjithë fëmijët megjithëse është përfshirë në legjislacion duket se është në një konflikt të vazhdueshëm me strukturat dhe praktikat në fushën e arsimit dhe më gjerë. Parimi i arsimit gjithpërfshirës, ndonëse është pranuar gjerësisht në të gjitha nivelet e institucioneve arsimore dhe është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit, ende zbatimi i tij në praktikë has shumë pengesa, të cilat lidhen me mungesën e akteve nënligjore të domosdoshme për zbatimin e ligjit.

Nisur nga ky realitet Koalicioni Shqiptar “Aftësia e kufizuar dhe Zhvillimi” kërkon të tërheqi vëmendjen për një sërë mangësish në zbatimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar, në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuadër, Koalicioni Shqiptar “Aftësia e kufizuar dhe Zhvillimi” i propozon Këshillit të Ministrave dhe direkt MAS: ***ngritjen dhe funksionimin e një departamenti për të monitoruar zbatimin e arsimit gjithpërfshirës pranë drejtorisë së arsimit parauniversitar, me qëllim të realizohet e drejta për arsim për gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar.***

Që arsimi gjithpërfshirës të shëndrrohet në një realitet, institucionet arsimore duhet të përfshihen në ndryshime në të gjitha nivelet e tyre, duke bërë përpjekje konkrete për t’ju përshtatur kërkesave dhe nevojave të çdo nxënësi. Reforma që përshpejton zbatimin e arsimit gjithpërfshirës, kërkon

transformime të mëdha në të gjithë sistemin e arsimit drejt procesit të përfshirjes sociale.

Prindërit, në ditët e sotme, përballen me një botë sfidash, që nga krijimi i kushteve për të siguruar ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre, tek arritja e lumturisë individuale dhe familjare, deri tek sigurimi i një mjedisi të sigurt, që nxit dhe stimulon rritjen fizike, emocionale dhe sociale të fëmijëve të tyre. Prindërimi është një proces që rrit kërkesat e prindërve dhe shumë familje herë pas here, e shohin prindërimin si një faktor stresues, por në disa raste edhe pse prindërve ju duhet të përballen me lindjen dhe rritjen e një fëmije me nevoja të veçanta, kjo situatë paraqitet ndryshe, ata sërish arrijnë të përjetojnë emocionet pozitive dhe kënaqësinë e të qenit prind.

Shoqëria e ka projektuar rolin e përfshirjes së prindërve në kujdesin për fëmijët si një përgjegjësi të nënës dhe si një mundësi të babait. Normat shoqërore diktojnë rolin e nënës si ofruese të kujdesit ndaj fëmijëve dhe rolin e babait si mbështetës dhe mbrojtës, e në këto kushte nënat shpesh ndjehen më të shpenguara të shprehin lirshëm përjetimet dhe emocionet e tyre për fëmijët me nevoja të veçanta dhe dinamikat e jetës familjare. Ndërsa këto role gjinore me kalimin e kohës janë kundërshtuar, ajo që vërehet më shpesh, ka të bëjë me faktin se janë nënat dhe jo baballarët, përgjegjëse për shumë çështje që lidhen me fëmijët, përfshi edhe arsimimin e tyre.

Mëmësia është një detyrë personale dhe njerëzore për çdo individ. Ajo është si një burim jetese që lidhet me jetën, por është gjithashtu edhe fija që lidh zhvillimin njerëzor me të ardhmen. Mëmësia kalon përmes shumë vështirësive dhe kënaqësive njëkohësisht. “Ajo” është “një proces që plotëson kërkesat e fëmijëve lidhur me sigurinë, rritjen dhe pranimin social, duke ofruar dashuri, edukim, trajnim. Mëmësia është përshkruar, gjithashtu, si instrument sigurie dhe mbështetjeje emocionale për një fëmijë. Përvoja e të qenit nënë, është e fuqishme dhe komplekse.

Mesazhi i mëposhtëm na tregon më së miri se përvoja e një nëne që përkujdeset për fëmijën e saj me nevoja të veçanta, është unike, e papërsëritshme, është e mbushur me plot emocione pozitive, më dashuri, me çaste të lumtura. Janë fjalët e zemrës së një nëne. Është emocionuese ti lexosh”.

Dialog me prindërit

Ti je ëngjelli im, ti je jeta ime

Ti je DIELLI që më ndriçon çdo mëngjes, që më ngroh me rrezatimin tënd dhe me shoqëron gjatë gjithë ditës. Dhe kur vjen mbrëmja ti nuk ikën por strukesh thellë në shpirtin tim, në zemrën time dhe më shoqëron në gjumë në ëndërrat e mia. Ne luajmë të dy, flasim dhe qeshim si dy shokë të mirë.

Ti më tregon mua për ëndrrat dhe dëshirat e tua në jetë dhe më flet papushim me zërin më të ëmbël në botë.

Një ëndërr që nuk mbaron, një ëndërr që shpresoj që një ditë të bëhet realitet.

Dhe ja vjen mëngjezi dhe unë ndiej dy sy të kaltër që më buzqeshin dhe dy buzë të kuqe që më thërrasin “Mami Eva”.

Je ti SHPIRTI IM, je ti DIELLI IM që më fal dashurinë më të madhe dhe më të pastër në jetë, atë dashuri që askush nuk e ka dhe nuk mund ta falë. Atë dashuri që ti e shpreh me sy, me buzë dhe me shpirt. Më përqafton fort dhe më bën të ndihem në qiell duke ecur në vendin më të bukur që egziston “NË PARAJSE” në një lëndinë me një gjelbërim fosforishent dhe mes luleve të shndritëshme dhe shumëgjyrshe, mes njerzve të mirë që i duam dhe na duan. Kështu ndihem unë me ty “ËNGJËLLI IM”.

“U BËFSH 111 VJEÇ ËNGJËLL”

Uroj që ditët e tua të jenë po kaq të bukura si tani dhe shpirti yt të jetë i pastër si kristali, ku asgjë në botë dhe për asnjë arsye në jetë të mos ndryshojë.

Sepse ti je një “ËNGJËLL”!



Etleva Ropi , Korçë

Ligjin “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

NENI 97

Mësuesi ndihmës dhe mësuesi lëndor në institucionet arsimore të zakonshme. Bashkëpunimi me prindërit

1. Sipas normës së përcaktuar nga ministri dhe vlerësimit nga komisioni pranë DAR/ZA-së, në klasat e zakonshme që kanë edhe fëmijë me AK, punojnë mësues ndihmës. Mësuesi ndihmës duhet të ketë diplomën e nivelit arsimor përkatës, të përcaktuar në nenin 57 të LAPU-s, dhe specializim të përshtatshëm në fushën e arsimimit të nxënësve me AK.

2. Mësuesi ndihmës, në bashkëpunim me mësuesin lëndor dhe prindin, hartojnë dhe venë në jetë PEI-në e fëmijës. PEI bazohet në dokumentet zyrtare të kurrikulës dhe përmban edhe objektiva për aftësitë e vetë-ndihmës dhe aftësi të tjera sociale, që nxënësi duhet të arrijë, sipas udhëzimeve të komisionit pranë DAR/ZA-së.

3. Mësuesi ndihmës shënon në planin ditari aspekte të ecurisë së fëmijës me AK.

4. Ndryshimi i PEI-s vendoset nga komisioni i institucionit në bashkëpunim me prindërit e fëmijës, pas propozimit të mësuesve ose prindërve.

5. Mësuesi ndihmës ose mësuesi kujdestar informon prindërit e fëmijëve me AK për shërbimet shtetërore shëndetësore rehabilituese që u ofrohen këtyre fëmijëve.

6. Pas marrrjes së rekomandimit nga komisioni pranë DAR/ZA, prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me AK do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë.

7. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur gjykojnë se fëmija nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

8. Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që veprimtaritë, që zhvillohen në institucionin arsimor dhe në shtëpi të plotësojnë dhe të përforcojnë njëri-tjetrin.

(....vazhdon në numrin e ardhshëm)

Të ndryshëm në nevoja por të barabartë në të drejta

Flutra Musta
Punonjëse Sociale



A mund të prezantoheni ?

Quhem Flutura. Kam 1 vjet që kam përfunduar studimet në masterin shkencor, shërbime sociale dhe jam diplomuar me titullin “ Punonjëse Sociale”. Jam e martuar dhe kam dy vajza njëra 20 vjeç e cila ndjek studimet për shkenca juridike dhe vajza tjetër 14 vjeç e cila është nxënëse e ciklit 9-vjeçar. Në shtator 2015 jam bërë pjesë vullnetare e stafit të shoqatës MEDPAK dhe specifikisht jap kontributin tim në projektin “Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri”.

Ku mbështetet puna që ju bëni?

Baza e praktikës së punës time si punonjëse sociale janë parimet e të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë sociale. Në projektin ku unë asistoj qëllim është gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla publike si një e drejtë e çdo fëmijë. Gjithëpërfshirja në arsim ka si synim përfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim race, gjinie, etnie, aftësie të kufizuar apo ndonjë dallim tjetër në shkollën më të afërt.

Aktualisht ofroj mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë në 2 shkollat ku po zbatohet projekti Fadil Gurmani – Elbasan dhe

Vasil Belshi – Shtërmen. Me mirëkuptimin e stafit të mësueve të këtyre shkollave unë bëhem pjesë e klasës ku ka fëmijë me AK dhe VN dhe monitorojë ecurin e këtyre fëmijëve. Diskutoj dhe ndaj informacion me prindërit dhe psikologën e shkollës.

A keni një format specific për monitorimin e këtyre fëmijëve ?

Po, është hartuar një formë monitorimi të cilën e plotësoj në ditët që jam në vëzhgim. Kjo formë përshkruan ecurin e fëmijës në 2 aspekte: aspektin e gjithëpërfshirjes sociale, mënyra se si femija komunikon, krijon marrëdhënie dhe aktivizohet në klasë dhe në aspektin akademik çfarë aftësish zotëron femija. Një specifike e kësaj forme monitorimi është suksesi i ditës së fëmijës. Gjatë vëzhgimit të çdo dite evidentohet suksesi që femija ka arritur gjatë orës së mësimi, kjo shërben si një orientim shumë i mirë për të zbuluar aftësitë që femija ka dhe për të ndërtuar më pas mbi këto aftësi. Fleta e monitorimit vendoset në dosjen e çdo fëmije për ti shërbyer psikologes së shkollës dhe mësuesve për hartimin e PEI (Plani Edukativ Individual)

Çfarë ju pëlqen nga puna juaj ?

Puna që bëj me këta fëmijë me jep një kënaqësi të veçantë sepse të jesh pranë fëmijëve dhe t'i ndihmosh ato në hapat e zhvillimit të tyre të bën të ndjehesh mjaft e vlerësuar dhe e rëndësishme. Ndjej kënaqësi që me njohuritë e mia profesionale i ndihmoj në përpjekjet e tyre për tu bërë pjesë e rëndësishme e shoqërisë sonë dhe më pëlqen kur shikoj tek trajtohen njësoj si fëmijët e tjerë me të drejta të plota dhe jo më si një plagë e pashërueshme e kësaj shoqërie.

Çfarë mesazhe jepni për prindërit ?

Dua ti kujtoj prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar që janë shtylla më e fortë ku këta fëmijë mbështeten. Nëse kjo shtyllë do të rrëzohet ose lëkundet atëherë dhe këta fëmijë do të bien ose do të humbasin ekulibrin, do të rrezikojnë të bien ose të humbin besimin. Prandaj jeni ju prindërit që në radhë të parë duhet t'i trajtoni dhe ti impononin shoqërisë që ata janë ndryshe thjeshtë në nevoja por të barabartë në të drejta. Ata falin shumë dashuri e mirënjohje. Punoni me ta dhe na ndihmoni edhe ne që të gjejmë pikat e tyre të forta e keto pika të forta t'i kthejmë në arritje dhe suksese jo vetëm të fëmijës, familjes po edhe të shoqërisë.

Kalendari i aktivitete

20 Nëntor 2015 – “Unë jam fëmijë, kam nevojë të jem i tillë, kam nevojë të gëzojë Të DREJTAT E MIA !!! Aktivitet i përbashkët i shoqatave me mbështetjen Bashkisë Elbasan

20 Nëntor 2015 – “Une kam të drejtë të argëtohem pavarishtë aftësive të mia !!! Aktivitet me animime organizuar nga shkolla Vasil Belshi Shtërmen, Elbasan.

3 Dhjetor 2015 - Sensibilizim i komunitetit për Çështjet e përfshirjes: akses (qasje) dhe fuqizim për njerëz të të gjitha aftësive. Organizuar nga nxënësit e shkollës 9- vjeçare “Qemal Mici” Durrës

3 Dhjetor 2015 – Aktivitet sensibilizues rreth mënyrës se si mund t’i vijmë në ndihmë bashkëmoshatareve me aftësi të kufizuar. Organizuar me mbështetjen e DSHP Elbasan. Shkolla Fadil Gurmani, Elbasan.

3 Dhjetor 2015 – “Mes jush i ngjashëm” - Aktivitet sensibilizues për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Organizuar nga nxënësit e shkollës 9- vjeçare 31 Korriku, Burrel.

10 Dhjetor 2015 – Tryezë teknike e Aftësisë së Kufizuar për krijimi i një rrjeti midis shoqatave dhe institucioneve publike për të fuqizuar dhe për të zhvilluar kultura dhe praktika gjithëpërfshirëse për Personat me Aftësi të Kufizuar

22 Dhjetor 2015 – “Mësuesi ndihmës dhe fëmija im”. Takim diskutimi me prindërit e fëmijëve me AK, Korçë – Elbasan

19 Janar 2016 – Tryezë teknike e Koalicionit Shqiptar “Aftësia e kufizuar dhe Zhvillimi” (ADDC), me teme “Të përshejtohen hapat që duhen hedhur në nxitje të zbatimit të ligjit për arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara”